


Magjistralia Prishtinë – Ferizaj,
km i 15-të, Lipjan




Rr. Turgut Ozal, pn
(ish – Zona industriale, Prizren)

kosova.maarifschool.org



HARTA E FONDACIONIT “MAARIF” NË BOTË



Fondacioni Turk Maarif, për të gjitha nivelet e arsimit, për 9 vjet eksistencë u bë institucion prestigjioz në botë për edukimin e mirëfilltë të nxënësve. Fondacioni Turk Maarif, operon në 64 vende të botës, me 500 shkolla, 2 universitete, 14 qendra arsimore dhe mbi 100 mijë nxënës aktivë.

Për të siguruar një edukim sa më cilësor për nxënësit tanë në kohën moderne, është veçanërisht e rëndësishme të sigurohen dhe zhvillohen mjetet dhe pajisjet arsimore, duke përfshirë:

- Mësues profesionistë, të përkushtuar ndaj nxënësve;
- Kurrikula të pasura dhe të përshtatura për nivele të ndryshme;
- Programet efikase për mësimin e gjuhëve të huaja;
- Strategji, teknika dhe metoda efektive të mësimdhënies;
- Teknologji të reja dhe zbatimi i tyre i përpikshëm për mësimin me largësi dhe materialet e platformave digjitale;
- Ambient bashkëkohor dhe miqësor, me mundësi gjithëpërfshirëse ku secili ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar.

PSE DUHET TË ZGJIDHNI SHKOLLËN MAARIF ?



Shkollat Ndërkombëtare Maarif të Kosovës, me stafin më të mirë arsimor në vend, zbatojnë metoda të avancuara mësimore dhe standarde të larta teknike në klasat e tyre. Përmes digjitalizimit me sistemin e-Maarif dhe aplikacioneve mobile, prindërit mund të kenë qasje të lehtë në informacion rreth mësimave, mungesave, detyrave, pagesave dhe më shumë.

Shkollat Ndërkombëtare Maarif të Kosovës fokusohen në përgatitjen e nxënësve për të ndjekur studimet e larta në universitetet më prestigjioze të botës. Maturantët tanë – jo vetëm në Kosovë, por edhe në vende si Turqia, Kanadaja, Italia, Gjermania, Hungaria, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut – i vazhdojnë studimet e tyre me sukses. Përveç kësaj, shkollat tona mbështesin nxënësit e nivelit të mesëm të lartë në zhvillimin e karrierës përmes sistemit të ndjekjes dhe udhëzimit profesional. Nxënësit kanë mundësi të vazhdojnë studimet me bursa në universitete të njohura botërore.

Gjithashtu, maturantët e shkollave Maarif mund të vijojnë studimet pa pagesë në çdo universitetet shtetëror në Turqi.

kosova.maarifschool.org



VLERË NË ARSIM!



Vizioni & Misioni

Duke ofruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës në Kosovë si pjesë e një institucioni ndërkombëtar pioner dhe të besueshëm. Misioni ynë është të formojmë individë të kompletuar, të frymëzuar nga trashëgimia e përbashkët e njerëzimit, tradita anatoliane e urtësisë dhe vlerat kulturore-historike të Kosovës.

Vlerat

- Besimi
- Bashkëpunimi dhe Solidariteti
- Transparenca
- Kualifikimi dhe Meritokracia
- Përfshirja / Inkluziviteti
- Respekti
- Universaliteti
- Mëshira
- Qëndrueshmëria
- Shkencorja / Bazuar në shkencë
- Cilësia

E ARDHMJA FILLON KËTU



Shkollat Ndërkombëtare Maarif të Kosovës, të themeluara në vitin 2017, ofrojnë arsim cilësor nga niveli parashkollor deri në atë të mesëm në kampuset e tyre në Prishtinë dhe Prizren.

Nga Kopshti deri në klasën e 12-të, nxënësit mësojnë anglishten si gjuhë të parë të huaj dhe turqishten si gjuhë të dytë të huaj, duke zhvilluar aftësi shumëgjuhëshe që në fazat e hershme të edukimit. Në nivelet parashkollor dhe fillor, gjuha kryesore e mësimdhënies është shqipja, ndërsa nga klasa e 6-të e tutje, gjuha e mësimdhënies është anglishtja, duke i përgatitur nxënësit për shkëlqim akademik në një mjedis ndërkombëtar.



FILOZOFIA E SHKOLLËS



Filozofia e shkollës bazohet në ofrimin e një edukimi cilësor dhe zhvillimin e “individit të mirë”, andaj bëhet fjalë për një individ, i cili:

- Mendon në mënyrë kritiko-analitike;
- Përqafon një vizioni shkencor;
- Respekton mjedisin, gjallesat dhe qeniet njerëzore;
- Ka ndërgjegje për shoqërinë, kulturën dhe historinë;
- Nderon rrethin, vendin dhe komunitetin e tij;
- Ka respekt ndaj diversitetit kulturor;
- Mbron vlerat e drejtësisë dhe respektit;
- Synon të ndërtojë një botë paqësore dhe të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Shkollat “Maarif” organizojnë aktivitete të ndryshme për zhvillimin e elementeve socio-kulturore, duke përfshirë:

- Vizita në vende kulturore dhe historike;
- Pjesëmarrje në klube edukative dhe projekte studimore;
- Kontribut në revistat shkollore, shfaqjet muzikore dhe teatrale;
- Aktivitete sportive dhe turne;
- Seminare, konferenca, simpoziume, panairë dhe ekspozita.

PROGRAMET MBËSHTETËSE



Marrëdhëniet pozitive midis prindërve, nxënësve dhe mësuesve përbëjnë themelin e mjedisit tonë arsimor.

Programi ynë i plotë mësimor përfshin një gamë të gjerë klubesh – si Klubi i Futbollit, Klubi i Solidaritetit, Klubi i Trashëgimisë Kulturore, Klubi i Origamit, Klubi “Agora”, Klubi i Eksploruesve të Biologjisë, Klubi i Gjuhëve, Klubi i Artit, Klubi i Lojërave Logjike, Klubi i Punimeve të Dorës, Klubi i Muzikës, Klubi i Folklorit, Klubi i Pingpongut, Klubi i Harkut, e shumë të tjera – duke ofruar mundësi të shumta për zhvillim krijues, intelektual dhe social.

Për më tepër, nxënësit mund të marrin pjesë në aktivitete tërheqëse dhe formuese si Qytetaria Globale, Klubi i Debatit, Klubi i Inteligjencës Artificiale, Kimia Argëtuese, Laboratori i Jetës, Prezantime Publike & Gazetari, Aftësi Jetësore, Klubi i Lojërave Logjike, si dhe programet e Artit & Muzikës.

Ndër programet mbështetëse të ofruara nga shkollat “Maarif” përfshihet edhe Bursa MAGIS, e cila mundëson përgatitje për shkollim falas deri në 100%.